REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 985-993/20
Datë/Datum. 22.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.985/20
993/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Sallahu"shpk - Kacanik dhe OE "Granit"shpk – Istog, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Joos & Krasniqi- Bazë" Shpk & "BK-Construction" Shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi i rrugës Peklen – Shtypeq i vogël – Varri i Sykut faza e dyte" me nr. të prokurimit: 635-20-5416-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Pejë, më datën: 18.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Sallahu"shpk - Kacanik lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës Peklen – Shtypeq i vogël – Varri i Sykut faza e dyte" me nr. të prokurimit: 635-20-5416-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Pejë.

II. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik OE "Granit" shpk – Istog, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës Peklen – Shtypeq i vogël – Varri i Sykut faza e dyte" me nr. të prokurimit: 635-20-5416-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Pejë.

III. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës Peklen – Shtypeq i vogël – Varri i Sykut faza e dyte" me nr. të prokurimit: 635-20-5416-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Pejë, dhe lënda kthehet ne **Rivleresim.**

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues "Sallahu" shpk – Kacanik aprovohet pjesërisht si e bazuara dhe OE "Granit" shpk – Istog, aprovohen si e bazuar, iu bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Sallahu" shpk - Kacanik, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 20.11.2020 me nr. 985/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i rrugës Peklen – Shtypeq i vogël – Varri i Sykut faza e dyte" me nr. të prokurimit: 635-20-5416-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Pejë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 27, 28, 51, 52, 59 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues "Granit"shpk – Istog, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 23.11.2020 me nr. 993/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i rrugës Peklen – Shtypeq i vogël – Varri i Sykut faza e dyte" me nr. të prokurimit: 635-20-5416-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Pejë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59, 64 dhe 66 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 24.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtuese të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues e prokurimit në raportin e dt: 02.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues/ Komuna Peje, gjate këtij aktiviteti te prokurimin ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është pune, kontratë publike me vlerë të madhe. Pretendimet kryesore ankimore kane te bëjnë kundër propozimit për dhënie te kontratës. Parashtruesit e ankesave me datën 07 dhe 08.11.2020, kanë parashtruar kërkesa për ri shqyrtim tek AK, megjithatë nuk kemi hasur se përgjigjet përkatësisht vendimet kundrejt te njëjtave kërkesa janë ngarkuar nga AK – Komuna Peje.

Përgjigje ne pretendimet ankimore (Neni 113) Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se disa nga pretendimet ankimore te dy OE-ve janë te përbashkëta dhe si te tilla do ti trajtojmë.

Pretendim i përbashkët ankimore është ai kundër menaxherit te projektit te prezantuar nga operatori ekonomik i propozuar për dhënie ku kontestohet CV apo përvoja e punës. AK – Komuna Peje, si dëshmi dokumentare ka kërkuar, "*Për menaxher të projektit , diploma e skanuar nga origjinali ose kopja e noterizuar, kontrata e punës, (në rast të angazhimit për këtë projekt, kontrata e menaxherit me ofertuesin duhet të jetë e noterizuar dhe e nënshkruar nga të dy palët në prezencë të noterit) dhe* ***letër referencat për së paku 3 projekte të përfunduara në fushën e rikonstruktimit ose ndërtimit të rrugëve****. CV, në të nënshkruar nga vet ingjinjeri".*

- Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie, si menaxher te projektit ka prezantuar z. Arsim Rapuca, me kualifikim shkollor, inxhinier i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv. Sipas përshkrimit ne CV dhe ne Referencat e prezantuara rezulton qe referencat janë lëshuar kryesisht për projektim te rrugëve, urave dhe ne mbikëqyrje, por jo për menaxhim te projekt te kryer ne rikonstruktimin apo ndërtimin te rrugëve siç është kërkuar nga AK.
- Inxhinieri tjetër i kontestuar / gjeodetin. AK – Komuna Peje, perkës kërkesave te kualifikimit nuk ka kërkuar qe i njëjti duhet te jete i licencuar ne Agjencinë Kadastra le te Kosovës.
- Përderisa për kërkesën nr 6, te kapacitetit teknik dhe profesional operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës ka prezantuar certifikatën e lëshuar nga MPMS, ne emër te z. Ndriqim Zeka, ku potencohet se i njëjti me datën 23.05.2019, ka dhëne provimin profesional për Siguri dhe Shëndet ne Pune.
- Po ashtu parashtruesit e ankesave pretendime te përbashkëta kane ngritur edhe kundrejt, disa nga pajisjet e punës te prezantuara nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës, përkatësisht, AK, tek aneksi 1, ka përshkruar llojin e pajisjeve, ne pozicionin 2, kontestohet "*Ekskavatori me rrota, me peshe min 15-20 tona me çekan hidraulik*". OE i rekomanduar ne liste ka përshkruar *"Fiat Hitachi, tipi Ex 215Ë.. "*, ku sipas dokumentit unik doganore i njëjti ka peshën prej 24

tona.

- Ne pozicionin 6, është kërkuar, "*Ngarkues, min 2-3m3 (1 cop)*". Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk ka prezantuar ndonjë ngarkues te kapacitetit te kërkuar nga AK.

- Ne piken 7, "*Cilindër me min 12-15 tona vibrues*", OE ka prezantuar, rul për shtrimin e rrugëve , jo vibrues me peshe prej rreth 22 ton.
- Ne pozicionin 16, është kërkuar "*Cilindër me rrota te kombinuara (gome dhe hekur) min 6-8 tona (1 cope)*". OE, i propozuar për dhënie nuk ka prezantuar ndonjë dëshmi për pajisje te njëjte sipas kapacitetit te kërkuar nga AK, rrjedhimisht vlerësimi i ofertave nuk është bere ne harmoni me nenin 59, te LPP-se, përkatësisht nuk janë mbuluar kërkesat e vete aplikuara kundrejt ofertuesve. Po ashtu ekzistojnë edhe dëshmi tjera te cilat janë te pa lexueshme si rezultat i skanimit te dobët.

Operatori ekonomik "Granit" shpk – Istog, ka ngritur pretendime ankimore edhe kundrejt ofertuesve tjerë te kualifikuar si te përgjegjshëm por te pa suksesshëm, përkatësisht kundrejt OE "Sallahu"shpk, ku potencohet se i njëjti nuk ka prezantuar dëshmi lidhur me pozicionin nr. 6, te kërkesave te kapacitetit teknik dhe profesional.

OE i njëjte ka prezantuar Certifikate Trajnimi, nga AQSCERT, ne emër te z. Ilmi H. Fetaj, megjithatë AK, ka kërkuar Certifikata për dhënien e provimit profesional nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Po ashtu i njëjti OE, potencon se Referencat e lëshuara kundrejt, inxhinierit z. Ermir Hasani dhe gjeodetit z. Fadil Shehu, te lëshuara nga OE "Sallahu"shpk janë fiktive. Lidhur me fiktivi tetin e shkresave ne nuk mund te japim ndonjë vlerësim real pasi qe nuk kemi kapacitet teknik apo profesional për vërtitësin e shkresave.

Kontestohet edhe pozicioni nr. 17, i listës se pajisjeve ku AK, ka kërkuar: "Cilindër me rrota hekuri me vibrim me peshe prej min 8-10 tona (2 cope). OE "Sallahu"shpk, sipas shkresave te prezantuara ne oferte ne kemi hasur ne një pajisje te tille jo siç është kërkuar nga AK, megjithatë ekzistojnë edhe dokumente unike doganore tjera te cilat është e pa mundur te lexohen si rezultat i kualitetit te dobët te printimit.

Po ashtu Operatori ekonomik "Granit" shpk – Istog, ka ngritur pretendime ankimore edhe kundrejt ofertës tjerë, përkatësisht kundrejt OE "RSM Company". Kontestohet marrëveshja e lidhur dhe e prezantuar me "Mineral LLC". OE i njëjte ka prezantuar marrëveshjen e njëjta e cila i mbulon kërkesat e AK-se, është përshkruar aktivitetit i prokurimit objekti i marrëveshjes, vulat dhe nënshkrimet e palëve, mos përshkrimi ne marrëveshje qe "pajisjet epen me qira", nuk e bene te pa përgjegjshëm operatorin ekonomik, po ashtu edhe lidhur me referencat e gjeodetit, ne kemi dhen sqarim me larte lidhur me pretendimin për referencat e pretenduara si fiktive.

Ndërsa lidhur me pozicionin 7, 17 dhe 18, te makinerive sqarojmë se i njëjti OE"RSM Company", ka prezantuar listën e pajisjeve dhe te mekanizimit te obligueshëm, ku janë te përshkruara pajisjet, megjithatë dëshmitë dokumentare, dokumentet unike doganore nuk kemi arritur ti administrojmë ne tërësi si rezultat i kualitetit te dobët te skanimit te shkresave, rrjedhimisht disa janë te pa lexueshme.

- Përfundimisht, ne mbështetje te asaj qe u përshkrua si me larte, rekomandimi ynë për AK – Komuna Peje është qe lenden ta kthej ne ri vlerësim me qellim qe te pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave te vete aplikuara ne dosje te tenderit konform nenit 59, te LPP-se.

Si prova shkresore se bashku me raport gjeni disa kopje te shkresave te ngarkuara nga OE-te, siç janë DUD, Certifikata etj.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve të aprovohen si pjesërisht të bazuara, të anulohet njoftimi, propozimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **Ri vleresim**.

Autoriteti Kontraktues me datë: 04.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se NUK PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Ju njoftojmë se kemi pranuar Ekspertizën ekspertitit nr 985-993/20 , dhe gjithashtu ju njoftojmë se ne si AK-se nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit, dhe arsyet e mos pajtimit janë këto:

Japim disa sqarime rreth pretendimeve te përbashkëta dhe pretendimeve tjera te O.E lidhur me operatorin ekonomik te propozuar për kontratë (Joos Krasniqi Baza & Bk Konstruction)

- **Sa** i përket menaxherit te projektit Arsim Rapuca i cili është ing ndertimtaris drejtimi konstruktiv, ku pretendohet se referencat per ketë ing, flasin kryesisht per projektim te rrugëve dhe urave dhe ne mbikqyerje por jo ne menaxhim te projekteve te kryera ne rikonstruktim apo ndertim te rrugëve . AK –se ka njohuri se ky ing. gati te gjitha projektet te cilat i ka projektuar pothuajse vet i ka menaxhuar, mirëpo gjatë perpilimit te Referencave është berë lëshim duke mos e venë ne fokus ketë qeshtje.
- **Të** qeshtja e gjeodetit dhe te qeshtja e çertifikatës te leshuar nga MPMS ne emer te Ndriqim Zekës , AK- se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.
- **Kurse** sa i përket qeshtjes se disa nga pajisjet e punës të prezantuara te aneksi **1** nga O.E i propozuar per kontrat , të cilat kontestohen kjo gje nuk qendron.

Të aneksi 1, të pozicioni 2, 6 , 7 dhe 16 te paisjet e kerkuar nga AK siq janë te cekuar tonazhat e çekanit hidraulik 15-20 ton -poz 2, Ngarkuesi kapac min 2-3 m3- poz nr 6, Cilinder min 16-20 ton – poz 7 dhe cilinder me rrota te kombinuara me pesh min 10 ton – pozicioni nr 16

Të te gjitha keto kerkesa kan qenë te caktuara sasit minimale nder te cilet parametra paisjet nuk pranohen(munden) me qenë , ndersa mbi keto limite nuk prishë punë fare, sa ma i madh qe te jetë tonanazha ose kapaciteti i paisjeve , infrastruktura rrugore do te jetë ma e fortë

Kesaj shkrese ia bashkangjesim aneksin 1 dhe kopjet e dudave doganor te ketyre paisjeve.

-----Sa i përket pretendimeve ankimore per O.E '' SALLAHU " shpk se ofetra e tij është e pa përgjegjeshme – nuk qendron .

Të qeshtja kontestuese lidhur me çertifikatën e trajnimit te Z. Ilmi Fetaj , jemi konsultuar edhe me autoritetet tjera komtraktuese te cilat e kanë kerkuar ketë kriter dhe te gjitha e kanë pranuar të njëjten çertifikat.

Kurse sa i perket qeshtjës se referencave te leshuara per ing, Ermir Hasani dhe Fadil Shehut , AK-se pajtohet me mendimin e ekspertit , se keto janë lehuar ne perputhshmeri me angazhimin e tyre ne projekte, kurse per verifikimin mbi origjinalitetin e tyre AK nuk ka pasur mundesi tjeter hulumtuese.

Të kontestimi i paisjës te pozicioni nr 17 te aneksi 1, ku është kerkuar cilinder me rrota hekuri me vibrim me pesh 8-10 ton. Edhe ketu është caktuar sasia minimale nder te cilat nuk ka mundesi me qenë kjo paisje , kurse pesha ma e madhe lejohet .

Sipas dudit doganor te cilin ja bashkangjesim kesaj kerkese ky cilinderi ka 10 ton e jo 12, pra i pergjigjet kerkeses se AK-se . Ky O.E ka ofruar edhe duda doganor te tjerë qe mund ti plotësoj te gjitha kekest e AK-se

Te ky AP autoriteti kontraktues ka pas konsiderat edhe ruajtjën dhe kursimin e paras publike qe është edhe moto kryesore e LPP-se.

Operatori Ekonomik- "Sallahu"shpk - Kacanik, me datë: 03.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Me datë 02.12.2020 kemi pranuar raportin e Ekspertit Shqyrtues të Prokurimit, lidhur me Ankesën nr 985/20 të datës 20.11.2020, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull *"Ndërtimi i rrugës Peklen- Shtypeq i vogël- Varri i Sykut, faza e dytë" me nr.të prokurimit 635-20-5416-5-1-1* të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna e Pejës, dhe bazuar në kërkesën nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për përgjigje lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues, Kompania Sallahu Shpk deklaron :

Pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim, dhe të anulohet propozimi për dhënie të kontratës si dhe qëndrojmë pranë të gjitha pikave të Ankesës me nr. 985/20 të datës 20.11.2020, duke pasur parasysh që edhe eksperti ka konstatuar që lënda të kthehet në rivlerësim me qëllim që të pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave në përputhje me nenin 59 të LPP-së, ndërsa me gjetjet e ekspertizës pajtohemi pjesërisht.

Meqenëse në ekspertizë sqarohen edhe pretendimet tendencioze të OE Granit Shpk ndaj Kompanisë tonë , ndaj të cilave kemi qëndruar indiferent, por kësaj radhe do të ofrojmë një sqarim;

l.Certifikatën të cilën e kemi ofruar për z.Ilmi Fetaj si person përgjegjës për siguri dhe shëndet në punë , në të gjitha Autoritetet Kontraktuese ku është kërkuar ky kriter kemi ofruar certifikatën e lartcekur dhe gjithmonë ka qenë e pranueshme, pasi që është çertifikatë e lëshuar nga një institut i licencuar për certifikim ndërkombëtar.

2.Sa i përket pretendimeve lidhur me fiktivitetin e referencave, eksperti shqyrtues e ka sqaruar shumë mire këtë pikë, andaj pretendimet e OE Granit janë tendencioze dhe me qëllim të dëmtimit të imazhit te Kompanisë tonë .

Me përgjegjësi të plotë deklarojmë se referencat mbi angazhimin e inxhinerëve janë lëshuar nga Kompania Sallahu Shpk, në përputhje me angazhimin e tyre në projektet e Kompanisë tonë.

Të gjitha punësimet dhe angazhimet e stafit Kompania Sallahu Shpk i bënë konfrom Ligjit të Punës dhe akteve të tjera ligjore mbi punësimin, dhe nuk mund të na e ndalon askush angazhimin e stafit dhe lëshimin e referencave, pasi qe punësimi, vërtetimi mbi përvojën e punës si dhe referencat mbi përvojën e punës rregullohen me ligje përkatëse .

3.Ndërsa për pikën 17 të Aneks 1 ,ku është kërkuar Cilindër 8-10t, dhe OE Graniti citon: ,që ky cilindër nuk i përgjigjet kërkesave nga AK dhe ka 12t.

Cilindri ka 10 t, sipas D.U.D-it me nr.serik 101400850127, dhe jo 12t, si dhe i përgjigjet kërkesave nga AK.

Megjithatë ashtu siç e ka potencuar edhe eksperti shqyrtues, në rast kontesti të kësaj pike Kompania jonë ka ofruar edhe dokumente unike doganore të tjera që e mbulojnë këtë pikë, por që për shkak të kualitetit të dobët kanë qenë të palexueshme.

Kompania jonë ka parashtruar Ankesë kundër vendimit për dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, dhe në këtë fazë ankesa jonë ka qenë e drejtuar ndaj OE të shpallur fitues, megjithatë mangësitë serioze dhe mos përputhjen me kushtet dhe kriteret e kërkuara të Dosjes së Tenderit për OE Granit Shpk nuk është se nuk i kemi vërejtur, por nuk janë relevante ne këtë fazë .

Andaj, duke pasur parasysh shkeljet e LPP-së dhe rregullave për prokurim publik qe kanë ndodhur gjatë vlerësimit të tenderëve në këtë aktivitet të prokurimit ,kërkojmë nga paneli shqyrtues që ta shqyrtojë ankesën tonë me nr.985/20 ,ta aprovojë si të bazuar, dhe në përputhje edhe me rekomandimin e ekspertit ta kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim

Operatori Ekonomik-"Granit" shpk – Istog me datë: 03.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues,

Konfirmojme pranimin e ekspertizes.

Parimisht pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues, mirepo vazhdojme te besojme qe pretendimet tona ankimore jane te bazuara ne faktet e paraqitura ne ankese!

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 18.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Pretendim i përbashkët ankimor i dy operatorëve ekonomik ankues është pretendimi kundër menaxherit të projektit të prezantuar nga operatori ekonomik i propozuar për dhënie, ku kontestohet CV apo përvoja e punës. Paneli Shqyrtues sqaron se AK, tek kërkesat që menaxherin, ka kërkuar që: "të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku tri (3) projekte te natyres se njejte (rikonstruktimi ose ndërtimi i rrugëve) dhe si dëshmi dokumentare ka kërkuar "Për menaxher të projektit , diploma e skanuar nga origjinali ose kopja e noterizuar, kontrata e punës, (në rast të angazhimit për këtë projekt, kontrata e menaxherit me ofertuesin duhet të jetë e noterizuar dhe e nënshkruar nga të dy palët në prezencë të noterit) dhe letër referencat për së paku 3 projekte të përfunduara në fushën e rikonstruktimit ose ndërtimit të rrugëve. CV, në të nënshkruar nga vet ingjinjeri". Për këtë kërkesë të AK-së, operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie, si menaxher te projektit ka prezantuar z. Arsim Rapuca, me kualifikim shkollor, inxhinier i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, kurse në lidhje me pikën e kërkesës "letër referencat për së paku 3 projekte të përfunduara në fushën e rikonstruktimit ose ndërtimit të rrugëve", Paneli Shqyrtues sqaron se sipas përshkrimit ne CV dhe në referencat e prezantuara rezulton që referencat janë lëshuar për projektim të rrugëve, urave dhe në mbikëqyrje, dhe nuk ka ofruar dëshmi se ka menaxhuar së paku tri (3) projekte te natyrës së njëjtë (rikonstruktimi ose ndërtimi i rrugëve). Për Panelin Shqyrtues, konform edhe mendimit të ekspertit shqyrtues, refrencat e ofruara për menxherin, nuk plotësojnë kërkesën e specifikuar në DT.

Në lidhje me inxhinierin tjetër të kontestuar / gjeodetin, Paneli Shqyrtues sqaron se AK përmes kërkesave të kualifikimit nuk ka kërkuar që i njëjti duhet të jetë i licencuar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Përderisa për kërkesën nr. 6, te kapacitetit teknik dhe profesional operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës ka prezantuar certifikatën e lëshuar nga MPMS, në emër të z. Ndriqim Zeka, ku potencohet se i njëjti me datën 23.05.2019, ka dhënë provimin profesional për Siguri dhe Shëndet në Punë.

Po ashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se parashtruesit e ankesave kanë pretendime të ngjashme edhe kundrejt disa nga pajisjet e punës të prezantuara nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, ku AK tek aneksi 1, ka përshkruar llojin e pajisjeve, në pozicionin 2 kontestohet "Ekskavatori me rrota, me peshe min 15-20 tona me çekan hidraulik". Paneli Shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar në listë ka përshkruar "Fiat Hitachi, tipi Ex 215W..", ku sipas dokumentit unik doganor i njëjti ka peshën prej 24 ton.

Në pozicionin 6, është kërkuar, "Ngarkues, min 2-3m3 (1 cop)", kurse operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka prezantuar ndonjë ngarkues të kapacitetit të kërkuar nga AK.
Në piken 7, "Cilindër me min 12-15 tona vibrues", OE ka prezantuar rul për shtrimin e rrugëve jo vibrues me peshë prej rreth 22 ton.
Në pozicionin 16, është kërkuar "Cilindër me rrota te kombinuara (gome dhe hekur) min 6-8 tona (1 cope)". OE i propozuar për dhënie nuk ka prezantuar ndonjë dëshmi për pajisje të njëjtë sipas kapacitetit të kërkuar nga AK. Me një kërkim të thjeshtë në internet, lehtë mund të shihet se cilindri i ofruar i markes HAMM Tip DV70VO, është cilindër me rrota hekuri dhe jo siç është kërkuar -me rrota të kombinuara (gomë dhe hekur). Prandaj, OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar cilindrin e kërkuar në DT.

Operatori ekonomik "Granit" shpk – Istog, ka ngritur pretendime ankimore edhe kundrejt ofertuesve tjerë të kualifikuar si të përgjegjshëm por të pa suksesshëm, përkatësisht kundrejt OE "Sallahu" shpk, ku potencohet se i njëjti nuk ka prezantuar dëshmi lidhur me pozicionin nr. 6, të kërkesave te kapacitetit teknik dhe profesional.
Paneli Shqyrtues sqaron se OE "Sallahu" shpk ka prezantuar certifikate trajnimi nga AQSCERT në emër të z. Ilmi H. Fetaj, megjithëse AK ka kërkuar Certifikata për dhënien e provimit profesional nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Certifikata e trajnimit e lëshuar nga një Kompani private, nuk është e barazvlefshme me Certifikatën për dhënien e provimit profesional e lëshuar sipas Ligjit në fuqi nga Institucioni shtetëror (MPMS). Për Panelin shqyrtues, edhe në këtë pikë nuk është plotësuar kërkesa e specifikuar në DT, përkatësisht nuk është ofruar dëshmia e kërkuar në DT.
Po ashtu i njëjti OE, potencon se Referencat e lëshuara kundrejt, inxhinierit z. Ermir Hasani dhe gjeodetit z. Fadil Shehu, te lëshuara nga OE "Sallahu"shpk janë fiktive. Lidhur me fiktivitetin e shkresave AK ka mundur të kërkojë informata shtesë nga OE ofertues që të sqarojë pretendimin e OE ankues lidhur me mospërputhjen e të dhënave ndërmjet CV dhe referencave të ofruara, gjithashtu gjat rivlerësimit AK mund te kërkoj sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se.

Kontestohet edhe pozicioni nr. 17, i listës se pajisjeve ku AK, ka kërkuar: "Cilindër me rrota hekuri me vibrim me peshe prej min 8-10 tona (2 cope). OE "Sallahu"shpk, sipas shkresave të prezantuara në ofertë ka ofruar Cilinder Bomag 213-2 me nr. Serik 101400850127. Me një kërkim të thjeshtë në internet, lehtë mund të shihet se cilindri i ofruar nuk është cilindër me rrota hekuri. Pajisja e ofruar në këtë pikë edhe sipas ekspertit shqyrtues nuk është siç është kërkuar nga AK.

Sipas mendimit të ekspertit shqyrtues, ekzistojnë edhe dokumente unike doganore tjera të cilat është e pa mundur të lexohen si rezultat i kualitetit të dobët te printimit. AK ka mundur të kërkojë nga OE ofertues

sqarime, pasiqë në DT (pika 8.) është kërkuar që: "dëshmitë duhet të jenë të dukshme".
Po ashtu Operatori ekonomik "Granit" shpk – Istog, ka ngritur pretendime ankimore edhe kundrejt ofertës tjetër, përkatësisht kundrejt OE "RSM Company".

Kontestohet marrëveshja e lidhur dhe e prezantuar me "Mineral LLC". OE i njëjtë ka prezantuar "Marrëveshjen për bashkëpunim" në nenin 1. të së cilës është shkruar: "Marrëveshje bashkëpunimi e cila nënkupton bashkërëndimin e punëve dhe aktiviteteve tjera të karakterit punues" ndërsa në DT, AK ka kërkuar që: "Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve". Për Panelin shqyrtues, kjo marrëveshje si e tillë nuk është marrëveshje për marrjen me qira të pajisjeve siç është këkuar në DT.
Po ashtu edhe lidhur me referencat e gjeodetit, është dhënë sqarim më lartë lidhur me pretendimin për referencat e pretenduara si fiktive.

Ndërsa lidhur me pozicionin 7, 17 dhe 18, të makinerive sqarojmë se OE "RSM Company", ka prezantuar listën e pajisjeve dhe të mekanizimit të obligueshëm.
Lidhur me pajisjen në pikën 7: "Cilinder min. 16-20 tona me dhembeza vibrues" – 1 cope, OE "RSM Company ka ofruar dy cilindra (Dynapac CA302 - Mineral dhe Cilinder Atlas Copco – Mineral). Me një kërkim në internet, sipas katalogjeve të prodhuesit, konstatohet se asnjëri nga cilindrat e ofruar nuk e plotësojnë peshën minimale të kerkuar në DT – Aneksi 1.

Lidhur me pajisjen në pikën 17, Cilindri i ofruar ne piken 17.2 - Cilinder Bitelli 10 ton – Oruci, me një kërkim në internet, vërtetohet pretendimi i OE ankues se ky cylinder nuk është cilindër me rrota hekuri siç është kërkuar në DT.

Lidhur me pajisjen në pikën 18 - pajisjet e nevojshme për punët e asfaltit është kërkuar: "Cilinder me rrota hekuri me vibrim me peshe min. 10 tona". Cilindri i ofruar VIBROMAX W1102 me një kërkim në internet, lehtësisht konstatohet se është cilindër me rrota gome dhe hekuri, pra jo siç është kërkuar: me rrota hekuri. Ndërsa për cilindrin e dytë të ofruar në këtë pikë - Dynapac CC222, pesha e tij (max. 8.400 kg) nuk plotëson minimumin e kërkuar prej 10 tonash.

Edhe sipas ekspertit shqyrtues, tek OE "RSM Company", disa nga dëshmitë dokumentare, dokumentet unike doganore nuk janë administruar në tërësi si rezultat i kualitetit të dobët të skanimit të shkresave, rrjedhimisht disa janë të pa lexueshme. Edhe këtu, AK ka mundur të kërkojë nga OE ofertues sqarime, pasi që në DT (pika 8.) është kërkuar që: "dëshmitë duhet të jenë të dukshme" dhe në rast të mos ofrimit të dokumenteve të lexueshme, konform kërkesës së tenderit, ta eliminojë ofertuesin e tillë.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK KK Pejë;

1x1 OE Sallahu shpk – Kaçanik;

1x1 OE Granit shpk – Istog;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.